



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/06
Datë: 10.03.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 mars, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/06
Datë: 10.03.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 11, 39, 44 dhe nenit 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, të nenit 53 të Ligjit Nr. 05/L-031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 mars, nxjerr këtë:

V E N D I M

për anulimin, ndryshimin dhe plotësimin e pjesërishëm të Vendimit Përfundimtar Nr.06/160 datë 11.12.2013

1. Anulohen shpronësimet e miratuara me Vendimin Përfundimtar 06/160 date 11.12.2013 për interes publik të pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga ndertimi i rrugës nacionale N2 Prishtinë - Mitrovicë, Segmenti Milloshevë-Smrekovicë, Loti II, Zonat Kadastrale: Pestovë, Maxhunaj, Studime e Poshtme, Dumnicë e Poshtme, Begaj, Nedakovc dhe Vushtri të Komunës së Vushtrisë, sipas tabelave pjesë përbërëse e këtij vendimi, **Aneksi I**.
2. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga ndertimi i rrugës nacionale N2 Prishtinë - Mitrovicë, Segmenti Milloshevë-Smrekovicë Loti II, Zonat Kadastrale: Begaj, Dumnicë e Poshtme, Maxhunaj, Nedakovc, Pestovë, Syracak, Studime e Poshtme dhe Vushtri të Komunës së Vushtrisë, sipas tabelave pjesë përbërëse e këtij vendimi, **Aneksi II**.
3. Mbeten në fuqi shpronësimet e miratuara me Vendimin Përfundimtar 06/160 date 11.12.2013 për interes publik të pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga ndertimi i rrugës nacionale N2 Prishtinë - Mitrovicë, Segmenti Milloshevë-Smrekovicë Loti II, Zonat Kadastrale: Pestovë, Maxhunaj, Studime e Poshtme, Begaj, Syracak, Nedakovc dhe Vushtri të Komunës së Vushtrisë, sipas tabelave pjesë përbërëse e këtij vendimi, **Aneksi III**.
4. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH, i dërgojnë vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi.
5. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë ditore me tirazh të madh në Kosovë.

6. Pjesë integrale e këtij vendimi është akti i vlerësimit dhe tabelat pjesë përbërëse e këtij vendimi në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve iu janë prekur nga procesi i shpronësimit.
7. Kundër këtij vendimi subjektet kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në gjykatën kompetente, vetëm për kundërshtimin e shumës së kompensimit të përcaktuar në këtë vendim, subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit, ne pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat pjesë përbërëse e këtij vendimi.
8. Brenda pesë (5) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që pesë (5) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në zyrën ligjore të Organit përkatës Shpronësues, nëse parashtruesi i ankesës nuk vepron në përputhje me këtë paragraf, gjykata e refuzon ankesën.
9. Brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit, Departamenti i Shpronësimit në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor do të paguajë plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të përcaktuar në këtë vendim.
10. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/06
Datë: 10.03.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4, 8, 44 dhe nenit 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 mars, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet shqyrtimi i mëtejme i kërkesës për shpronësim për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga ndërtimi i Rrugës Nacionale N2 Prishtinë-Mitrovicë, Segmenti Gojbulë-Smrekovnicë Loti I, zonat kadastrale: Smrekovnicë, Dobërllukë, Bajskë, Sllatinë(Gjelbrishtë), Vushtri dhe Gojbulë të Komunës së Vushtrisë, sipas tabelave të përshkruar nga evidencat kadastrale përkatëse për titullarët e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik si dhe sipërfaqeve të tyre, të cilat tabela janë pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Vlera e kompensimit të pronave do të caktohet nga Ministria e Financave dhe Transfereve, konform Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 dhe Udhëzimit Administrativ nr.02/2015 "Për zbatimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përlllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin".
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (MIA) dhe Ministria e Financave dhe Transfereve.
4. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/06
Datë: 10.03.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 mars, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Shëndetësisë për aprovimin e Planit për gatishmëri dhe reagim kundër Corona Virusit dhe Planin e veprimit.
2. Obligohet Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Financave dhe Transfereve dhe institucionet tjera relevante, të kryejnë të gjitha procedurat për zbatimin e këtij Vendimi.
3. Pjesë e këtij Vendimi është Shtojca nr.1.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/06
Datë: 10.03.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 dhe 51 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 mars, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Rithemelohet Komiteti Drejtues i Projektit të Asistencës Teknike "Energjia nga Linjiti", i themeluar me Vendimin e Qeverisë 08/17 të 1 qershorit 2011.
2. Emërohen anëtarë me të drejtë vote të Komitetit Drejtues:
 - 2.1. Rozeta Hajdari, ministre e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike, kryesuese;
 - 2.2. Besnik Bislimi, ministër i Financave dhe Transfereve, anëtar;
 - 2.3. Lumir Abdixhiku, ministër i Infrastrukturës dhe Mjedisit, anëtar;
 - 2.4. Emilija Rexhepi, ministre e Administrimit të Pushtetit Lokal, anëtare;
 - 2.5. Ivan Milojevic, ministër i Zhvillimit Rajonal, anëtar.
3. Emërohen anëtarë vëzhgues të Komitetit Drejtues:
 - 3.1. një përfaqësues i Zyrës së Rregullatorit për Energji;
 - 3.2. një përfaqësues i Korporatës Energjetike të Kosovës; dhe
 - 3.3. një përfaqësues i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale.
4. Komiteti Drejtues do të marrë vendime në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës për çështje që kanë të bëjnë me projektin e termocentralit "Kosova e Re".
5. Komiteti Drejtues do të marrë vendimet me shumicë votash.
6. Shfuqizohet Vendimi i Qeverisë 08/17 i 1 qershorit 2011.
7. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/06
Datë: 10.03.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 mars, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. I kërkohet Agjencisë Kosovare të Privatizimit të pezullojë për afat të pacaktuar të gjitha veprimet në lidhje me pronat e paluajtshme nga "Lista e Aseteve për Qiradhënie - me karakter specifik - e azhurnuar", e shpallur më 5 mars 2020.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Neni 5.3 i Ligjit 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar, parasheh që "Agjencia merr parasysh të gjitha politikat përkatëse të cilat mund të miratohen nga Qeveria ose Kuvendi i Kosovës".

Duke marrë parasysh Programin e Qeverisë 2020-2023, që parasheh politika për administrimin afatgjatë të pronës publike dhe shoqërore, Qeveria vendosi si në dispozitiv.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë